



No. 2731/2 Prot.
Dj. 13.07.2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT FIER

Nr. 1048/Prot.

Fier, më 12.07.2018

Lënda: Kthim përgjigje për ligjshmëri të vendimeve të Këshillit Bashkiak Roskovec

Drejtuar: Zj. Majlinda BUFI
Kryetar i Bashkisë Roskovec

Zj. Eleni GOGA
Kryetar i Këshillit Bashkiak Roskovec

ROSKOVEC

ROSKOVEC

Bazuar në *Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 16* shqyrtuam vendimet e Këshillit të Bashkisë Roskovec të marra në mbledhjen e datës 28.06.2018.

Vendimi nr. 48 datë 28.06.2018 - " Për miratim të dokumentit të Nismës për Hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec " është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " neni 54 /k dhe neni 23 pika 14 dhe në zbatim të ligjit Nr. 107/2014 " Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit " i ndryshuar neni 12 pika 2/a.

⁵⁰
Vendimi nr. 49 datë 28.06.2018 - " Për miratim e transferim fondesh dhe ndryshime në buxhetin e Bashkisë për vitin 2018 " është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " neni 54/ dh dhe neni 27 pika 1 dhe në zbatim të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH. i ndryshuar.

⁴⁹
Vendimi nr. 50 datë 28.06.2018 - " Për miratim e dokumentit të projekt buxhetit afatmesem 2019 - 2021 për Bashkinë Roskovec " është në përputhje me ligjin Nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore " neni 54/ dh dhe neni 27 pika 1 dhe në zbatim të ligjit Nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH i ndryshuar.

PREFEKTI

Baki BALA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 48. DATË 28.06.2018

“PËR MIRATIM TË DOKUMENTIT TË NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË ROSKOVEC”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 14; ligjin 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar neni 12 pika 2 shkronja a), dhe VKM nr. 686, date 22.11.2017, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, neni 3, Këshilli i Bashkisë.

VENDOSI:

1. Miratimin e Dokumentit të nismës për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Roskovec

Nisma e ndërmarë do t’i hapë rrugë të gjithë procesit të hartimit të PPV-së, në përputhje të plotë me të gjitha procedurat e parashikuara nga ligji,

Dokumenti i nismës përmban:

- a) Analizën e cila përcakton qëllimin dhe nevojën për hartim të dokumentit të planifikimit;
- b) Dokumentet që përcaktojnë zona të rëndësisë kombëtare;
- c) Kufijtë e territorit të Bashkisë Roskovec
- d) Planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të planit të përgjithshëm vendor
- e) Mënyrën e miratimit të tij, në një ndalesë.
- f) Lista e dokumenteve përbërëse të PPV-së
- g) Ekspertët (fusha e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës, hartues të PPV-së

- h) Përcaktime për Forumin Këshillimor Vendor
 - i) Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike dhe afateve përkatëse
 - j) Buxheti për hartimin e PPV-së
 - k) Sipas rastit, vendimi për pezullimin e zhvillimit për të gjithë ose një pjesë të territorit të njësisë vendore, sipas nenit 33 të ligjit të shoqëruar me hartë përkatëse.
2. Vendimi për miratimin e Nismës dhe dokumenti i Nismës botohet në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e miratimit.

KRYETAR

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC

DOKUMENTI I NISMËS
PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
(PPV) TË BASHKISË ROSKOVEC



PËRMBAJTJE

1. Hyrje
2. Analiza, qëllimi dhe nevoja për hartim të dokumentit të planifikimit;
3. Përcaktime për Zonat e Rëndësisë Kombëtare;
4. Kufijtë e territorit të njësisë vendore;
5. Planin e veprimeve për hartimin e dokumentit të Planit të Përgjithshëm Vendor;
6. Mënyrën e miratimit të PPV: në një apo dy ndalesa,
7. Përmbajtja e dokumenteve përbërëse të PPV-së;
8. Ekspertët (fushat e ekspertizës) që do të përbëjnë grupin e punës që do të hartojnë PPV-në;
9. Përcaktime për Forumin Këshillimor të Planit;
10. Përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike dhe afatet përkatëse;
11. Buxhetin për hartimin e PPV-së;
12. Zhvillimi në territorin e bashkisë deri në miratimin e PPV



HYRJE

Bashkia Roskovec është pjesë e Qarkut Fier dhe ka një sipërfaqe prej 118.01 km², me qendër qytetin e Roskovecit. Ajo kufizohet në veri nga Bashkia Lushnje, në lindje me Bashkinë Ura Vajgurore, në juglindje nga Bashkia Berat, në perëndim me Bashkinë Patos dhe Fier, ndërsa në jug me Bashkinë Mallakastër. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative, të cilat janë: Roskoveci, Strumi, Kumani dhe Kurjani. Bashkia e Roskovecit, në bazë të statistikave të vitit 2011 sipas Censusit regjistronte 21.742 banorë dhe densitet prej 184 b/km², ndërsa sipas Regjistrisë të Gjendjes Civile 32.163 banorë.

Ky dokument paraqet një panoramë të përgjithshme të gjendjes ekzistuese të territorit të Bashkisë Roskovec dhe nevojës së hartimit të dokumentit të sipër përmendur, krahas kërkesës ligjore për hartimin e këtij dokumenti. Në këtë dokument paraqitet gjithashtu dhe plani i veprimeve që do të ndërmerren deri në miratimin përfundimtar të planit të zhvillimit të territorit të Bashkisë Roskovec.

Bashkia Roskovec synon të krijojë një mjedis institucional, ekonomik dhe social për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit. Për të realizuar këtë qëllim nevojitet garantimi i transparencës në planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe në proceset ligjore që i rregullojnë ato.

Për të realizuar këta objektiva, do të zbatohen një sërë politikash. Një ndër to është nisja e punës për hartimin dhe miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV), si përkthim i strategjisë vendore të zhvillimit në territor dhe bazë për zhvillimin e qëndrueshëm, investimet dhe kontrollin e territorit. PPV është planifikimi, që shtrihet në të gjithë territorin e Bashkisë Roskovec, ndërkohë që "planifikimi i territorit" në vetvete është një veprimtari ndërdisiplinore për planifikimin e përdorimit të tokës, përcaktimin e kushteve për zhvillimin e territorit dhe të strukturave natyrore e të ndërtueshme në të. Në vijim të këtyre termave vlen të nënvizohet se "politikat territoriale" përbëjnë aktin më të lartë të planifikimit të territorit, me anë të të cilit realizohen programet dhe veprimtaritë në këtë fushë, për të arritur objektiva e qëllime të identifikuar. Ky proces do të bazohet në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" si dhe legjisllacionin sektorial në fuqi.



1. ANALIZA, QËLLIMI DHE NEVOJA PËR HARTIM TË DOKUMENTIT TË PLANIFIKIMIT

▪ Analiza e situatës ekzistuese;

a. Vendndodhja gjeografike dhe klima

Bashkia e Roskovecit shtrihet në zonën jugore të Shqipërisë në Qarkun e Fierit. Pozita gjeografike e këtij rajoni vlerësohet si shumë e favorshme për zhvillimin e tij ekonomik, e cila lidhet me faktin se rajoni tradicionalisht ka shërbyer si zonë me prodhim të lartë bujqësor dhe blegtoral për tregun vendas dhe eksportin. Roskoveci ka një popullsi që jeton në këto toka prej shumë kohësh. Ai njihet që prej kohëve më të hershme si qendër e banuar. Ngujimet e zbuluara arkeologjike dhe, sidomos kishtarë, flasin për një popullim dhe zhvillim domethënës, të paktën që prej shekullit 12-të pas Krishtit të kësaj treve. "Pazari i Roskovecit" është toponimi më i hasur dhe më popullor në të gjithë zonat shqipfolëse, jo vetëm për hershmërinë e zhvillimit të këtij tregu mbarëkombëtar, por dhe për madhësinë e konsiderueshme të marrëveshjeve financiare dhe juridike të lidhura në këtë qytet në ditët e zhvillimit të "pazarit". Jo më kot, ngrehinat më të vjetra të qytetit, një pjesë e të cilave mbijetojnë dhe sot, janë të njohura si ngrehina tregtare. Zhvillimi si qendër tregtare i Roskovecit ka ecur natyrshëm për shkak të vendndodhjes së tij në kryqëzim të udhëve të rëndësishme të kohës si: Vlorë-Fier-Berat, më herët, pranë udhës "Egnatia", degëzimi më i rëndësishëm i së cilës zbriste deri në Roskovec.

Rajoni dallohet për kushtet e tij specifike lidhur me klimën dhe hidrografinë. Kështu, në dallim me rajonet e tjera të vendit ky rajon ndodhet kryesisht nën ndikimin e klimës me tipare kontinentale. Kjo klimë gjen pasqyrimin e vet edhe në pasurinë ujore të rajonit, e cila përfaqësohet me forma të ndryshme të saj, si: liqene, lumenj, bimësi natyrore etj.

Klima e rajonit me tipare kontinentale kushtëzohet nga lartësia e tij mbi nivelin e detit, largësia nga deti etj. Një klimë e tillë bën që rajoni të dallohet për dimrin mesatar dhe verën e nxehtë. Të gjitha parametrat e klimës flasin për karakterin e saj kontinental. Kështu temperaturat mesatare të ajrit lëkunden 10°C në dimër dhe rreth 30°C në verë.

Regjistrimi i reshjeve në përgjithësi është në tërësi i karakterit mesdhetar, por në krahasim me rajonet e tjera të vendit nuk vërehet shpërpjestim i madh në rënien e reshjeve gjatë stinëve të vitit. Kështu në verë, që është stina më e thatë e vitit bien mesatarisht 13% e reshjeve vjetore, ndërkohë që në rajonet e tjera gjatë kësaj periudhe bien me pak ose pothuajse aspak reshje. Rajoni ka disa burime artificiale ujore në formën e rezervuareve, të cilat përdoren për qëllime të bujqësisë.



Klima e Rajonit Jugor vlerësohet optimale për zhvillimin e veprimtarisë bujqësore në të, sidomos për kultivimin e disa kulturave bujqësore, si: perime, drithëra, bimë industriale, frutikulturë, ullishte, vreshatri etj.

Rajoni dallohet për shumëllojshmeri të botës bimore e shtazore. Pothuajse të gjitha katet bimore të vendit tonë janë të perfaqësuar me bimesine e tyre, shkurret, dushqet. Sipërfaqet më të mëdha të tyre mbulojnë zonat kodrinore, kurse në ato fushore bimësia natyrore është zëvendësuar në pjesën më të madhe nga ajo e kultivuar. Në brendësi të kësaj bote bimore rriten lloje të ndryshme kafshësh dhe shpendësh të egra. Rezervate të rëndësishme përbëjnë basenet ujore ku rriten lloje të ndryshme peshqish.

b. Gjendja mjedisore

Për shkak të pozitës gjeografike dhe klimës së përshkruara më sipër, cilësia e ajrit, sidomos në zonat me lartësi më të madhe mbi nivelin e detit është më e mirë. Prania e sipërfaqeve të pyllëzuara, rezervuarëve ujorë dhe sipërfaqeve të mbjella me ullishte dhe frutikulturë ia shtojnë vlerat mjedisore rajonit. Por megjithatë, mosmenaxhimi i mbetjeve urbane të ngurta dhe të lëngëta përbën një problem ende të pazgjidhur. Venddepozitimi i vetëm aktual nuk përmbush kapacitetet e duhura, për të menaxhuar mbetjet e 14 fshatrave. Pra, shihet si domosdoshmëri, ndërtimi i një venddepozitimi të ri në fshatin Kuman, për të cilin është hartuar një studim i mirëfilltë gjeologjik, fizibiliteti dhe mjedisor, si dhe projekti i zbatimit. Krahas tyre, problematika të tjera që rëndojnë gjëndjen mjedisore janë pluhurat e shtuara nga infrastruktura e dëmtuar, mungesa e pemëve në disa rrugë, mungesa e kanalizimeve të zeza në çdo zonë të fshatrave, dhe shërbimi i dobët i pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapësirave urbane të Bashkisë Roskovec.

c. Të dhënat sociale ekonomike

Sipas regjistrit të Gjendjes Civile, në Bashkinë Roskovec figurojnë 32.163 banorë, por ky numër pritet të shtohet. Zona e Roskovecit njihet si arsimdashëse, ndaj dhe numri i të rinjve që mbarojnë studimet e larta dhe ofrojnë kontributin e tyre në komunitet është i konsiderueshëm.

Numri i bizneseve dhe shërbimeve që ofrohen në territorin e Bashkisë është gjithnjë në rritje dhe banorët po ndërgjegjësohen gjithnjë e më tepër në rregullsinë e pagesave të taksave dhe detyrimeve. Ekzistojnë një numër fabrikash të përpunimit të vajit të ullirit, tregtimi i peshkut, kantina të verës, sera agri-kulturore, etj që japin kontribut në ekonominë lokale. Megjithatë shumica e popullsisë i sigurojnë të ardhurat e tyre nga bujqësia dhe tregtimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale. Këtu kultivohen rreth 70 lloje bimësh, si drithërat, bimët industriale, perimet, ulliri, agrumet dhe dru-frutorët. Sot, Roskoveci ka një sistem bonifikimi dhe një popullsi aktive me përvojë në fushën e prodhimit bujqësor.



d. Zhvillimi i territorit

Aktualisht territori i Bashkisë Roskovec, sipas ndarjes së re administrativo-territoriale përfshin 14 fshatra, tek të cilët synohet vazhdimisht investimi dhe transformimi. Bashkia Roskovec e shikon të nevojshëm hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, edhe për faktin se ky plan do të ndikojë drejtpërsëdrejti në mirëmenaxhimin e territorit. Në disa rajone, të ndodhura jashtëzonave urbane qytetarët kanë shprehur interes për të zhvilluar dhe ndërtuar zonën, por pa hartimin e PPV-së, zhvillimi do të ishte sporadik e i pabalancuar. Zhvillimi i territorit është drejtimi ku investohen shumica e fondeve të Bashkisë dhe granteve të Qeverisë apo donatorëve. Përparësi i është dhënë infrastrukturës rrugore dhe shtimi i hapësirave të gjelbëruara dhe rekreative.

▪ Profili i bashkisë

Pas miratimit të ndarjes së re administrative-territoriale në vitin 2015, Roskoveci mbajti statusin e “Bashkisë”, si një nga 61 bashkitë e vendit tonë. Pozitiv është fakti se kjo bashki rifitoi territoret e saj, duke përfshirë edhe fshatrat e ish-komunave Strum, Kuman e Kurjan. Qendra e Bashkisë është në Roskovec dhe ka në përbërje edhe 4 Njësi Administrative: Roskovec, Kuman, Kurjan dhe Strum.

Aktualisht në territorin e Bashkisë Roskovec përfshihen 14 fshatra, me një popullsi prej rreth 32 163 banorë, sipas Regjistrit të Gjendjes Civile.

▪ Faktorët kryesorë që çojnë në nevojën e menjëhershme për hartimin e këtij plani janë

- Mospasja e një dokumenti planifikimi në fuqi;
- Ndryshimi i kufijve administrativë të njësisë vendore në zbatim të reformës administrativo-territoriale.
- Zhvillimi kaotik dhe përdorimi jo racional i tokës dhe burimeve natyrore;
- Papunësi dhe mospërputhje e profesioneve të ofruara me ato të kërkuara nga tregu i punës;
- Nivel i ulët i investimeve të huaja;
- Shumë zona me ndërtime në territorin e bashkisë nuk kanë infrastrukturë rrugore të duhur dhe shërbime të tjera publike (lagjet e reja);
- Sektorë të pazhvilluar përkundër potencialit relativisht të lartë: ekonomi, bujqësi, etj;
- Nivel i ulët i industrisë përpunuese;
- Probleme të vazhdueshme me ujitjen dhe kullimin për një pjesë të madhe të tokave në fushë;



- Dëmtim të sipërfaqeve prodhuese nga ndërtimet private dhe industriale;
- Sipërfaqe toke të lëna djerrë;
- Nivel shumë i ulët i zhvillimit e agro-përpunimit;
- Zona ekonomike nuk ka kushtet e nevojshme si në akses dhe në infrastrukturë;
- Vendbanimet dhe popullsia janë të shpërndara në disa fshatra dhe bëjnë të vështirë ofrimin e shërbimeve;
- Kthimi i tokës bujqësore në truall urban dhe parandalimi i dëmtimit të sistemit të vaditjes;
- Mungesa e pemëve shkakton rreshqitje të dheut në disa zona (fshati Luar) dhe shtim të ndikimit të erës;
- Përmirësimi dhe zgjerimi i metejshëm i rrjetit rrugor dhe hapësirave të gjelbra;
- Rrjeti aktual i kanalizimeve është i pamjaftueshëm dhe nuk ka një Impiant trajtimi të ujrave të zeza;
- Mungesë aktiviteti në masat e mbrojtjes së mjedisit (menaxhimi i mbetjeve, ujërave të përdorura);
- Probleme të mjedisit; mbeturina urbane dhe kanalizime të papërshtatshme të ujrave të zeza, të cilat ndikojnë tek turizmi
- Pamjaftueshmëri në furnizimin me ujë të pijshëm me pasoja për biznesin, turizmin dhe bujqësinë;

Arsyet për ndërmarrjen e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, lidhen si me kuadrin ligjor ashtu dhe me gjendjen ekzistuese të Bashkisë Roskovec. Me Ligjin Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, kufijtë administrativë të Bashkisë Roskovec, përfshijnë tashmë një territor prej 118.01 km². Për rrjedhojë hartimi i një Plani të Përgjithshëm Vendor është një domosdoshmëri përpara dinamikave të zhvillimit të këtij territori.

Plani i Përgjithshëm Vendor do të integrojë dhe trajtojë së bashku dhe në mënyrë të pandashme të gjitha njësitë administrative pjesë e Bashkisë Roskovec.

Nga ana tjetër, Ligji Nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, orienton të gjitha njësitë vendore në hartimin e planit. Në këtë mënyrë hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor vjen jo vetëm si detyrim ligjor por dhe si nevojë për zhvillimin e mëtejshëm dhe gjithëpërfshirës të territorit të Bashkisë Roskovec.



Mbështetur dhe në rezultatet e analizave të mësipërme, Plani i Përgjithshëm Vendor, përmes planifikimit të kujdesshëm dhe zbatimit të instrumenteve përkatëse, tenton të zgjidhë problemet ekzistuese që lidhen me çështjet e ndotjes së mjedisit, ajrit, ujërave nëntokësore, zhvillimit informal etj. Nga ana tjetër, Plani i Zhvillimit adreson në mënyrë të veçantë dhe çështje të cilat lidhen me situatën social-ekonomike, ku nëpërmjet politikave të zhvillimit synohet nxitja e ekonomisë lokale dhe rajonale, ulja e nivelit të papunësisë dhe rritja e mirëqënies sociale dhe ekonomike.

Krahas problematikave të mësipërme, Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Roskovec, do të vendosë theksin në zgjidhjen e problematikave të lidhura me zhvillimin e territorit si informaliteti, humbja e tokave bujqësore, mungesa e infrastrukturave publike etj.

▪ Qëllimi i këtij plani

Duke ndjekur objektivat e përgjithshme të Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit si dhe objektivat strategjike të programit qeveritar dhe të strategjive kombëtare sektoriale ky projekt ka si objektiv realizimin e një Plani të Përgjithshëm Vendor të qëndrueshëm që siguron menaxhimin e tokës nëpërmjet sigurimit të instrumentave të planifikimit dhe kontrollit të territorit.

Objektivat specifike përfshijnë :

- Zhvillimin, futjen dhe aplikimin praktik të metodave planifikuese urbane lokale të detyrueshme që t'i përshtaten tregut;
- Kultivimin dhe formulimin e veprimtarive të partneritetit ndërmjet bashkisë ndërmarrjeve/agjencive të infrastrukturës, zhvilluesve, pronarëve të tokës, pushtetit qendror dhe grupeve të tjera të interesit, nëpërmjet një procesi konsultimesh dhe pjesëmarrjes aktive;
- Rritjes së kapacitetit të planifikimit, kontrollit të zhvillimit dhe menaxhimit të tokës në departamentet përkatëse të pushtetit lokal.

Objektivat e Planit të Përgjithshëm Vendor janë:

- Balancimi i nevojave dhe interesave kombëtare e vendore për zhvillimet në territor;
- Krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor;
- Rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetin e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit;
- Planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme,



- peisazheve dhe hapësirave të gjelbra;
- Rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servituket publike;
- Rregullimi i ruajtjes, përdorimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike.

2. PËRCAKTIME PËR ZONAT E RËNDËSISË KOMBËTARE,

- zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit si zona me karakteristika të veçanta kulturore, historike, ekonomike, sociale ose mjedisore
- **Kisha “Shën Kollit”, Kurjan.** Një monument i shekullit të XIII, i ndërtuar në stilin bizantin. Pikturat murale që zbukurojnë brendësinë e kësaj Kise, janë veprat e ikonografit Nikolla, biri i Onufrit dhe ndihmësit të tij, Joanit. Kjo kishë është shpallur monument kulture nga:
 - i) Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Vendim Nr. 6, datë 15.01.1963;
 - ii) Ministria e Arsimit dhe Kulturës Drejtoria e Kultures, Vendim Nr. 68/7, datë 30.05.1970;
 - iii) Ministria e Arsimit dhe Kulturës Vendim Nr.1886, datë 10.06.1973.;
- **Kisha e “Shën Gjergjit”, Strum,** e ndërtuar në shekullin e XVII, e ngritur në një bregore të butë dhe e veshur me gjelbërim. Kjo Kishë është e ndërtuar në vitin 1782 dhe ka një gjatësi prej 10 metra dhe lartësi 3.5 metra. Këmborja është pjesa më e ruajtur e objektit;
- **Liqeni i Kurjanit,** një nga rezervuarët më të mëdhenj dhe produktiv që i jep jetë Myzeqesë, pa të cilin nuk do të quhej “hambari i Shqipërisë”. I ndërtuar në një vend të studiuar, ky rezervuar filloi të vihet në punë në vitin 1960 dhe kishte rreth 33 milion metër kub ujë. Bashkia Roskovec ka filluar pyllëzimi e kësaj zone. Deri tani janë mbiell rreth 14,000 rrezë, për ta rikthyer këtë zonë në një nga piakt më të rëndësishme turistike;
- **“Këneta e Zezë”, Strum,** para bonifikimit krijonte një basen të madh kënetor, por sot nga ky basen kanë mbetur rreth 3 ha tokë nën ujë. Ajo u ka rezistuar kohërave, orgjinale, si para shumë vitesh, me kallëma të egër nënujor, peshq, shpendë dhe me karakteristikën kryesore, ujin e zi dhe asnjëherë shterues. Do të shihej si përparësi shpallja e këtij baseni, “ Monument natyre”, për vetë vlerat që ajo mbart.
- **Pylli i Luarit, Luar si përfitues edhe nga “Programi i 100 fshatrave”**
Programi i 100 fshatrave synon të koordinojë ndërhyrjet zhvillimore në hapësirën rurale të 100 fshatrave. Bashkia e Roskovecit ka përfituar nga kjo nismë nëpërmjet zhvillimit të fshatit Luar si pjesë e territorit të saj. Investimet e integruara do të bëjnë të mundur që të investohet në 3 fusha kryesore:

